OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRŽIŠTA KOSTT d.d
Nr. 339 Dt. 29/05/2012
PRISHTINË-A

# KOSTT

# Raport për tremujorin e parë 2012

## (01.01.2012-31.03.2012)

| | Përgatiti | Kontrolloi | Aprovoi |
|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Shpresa Kursani | Fadil Ismajli KSHE | Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada |
| Nënshkrimi | | | |
| Data | *Prill, 2012* | | |

**Raport Tremujor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT**
**Përiudha Janar - Mars 2012**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Titulli i Dokumentit | Raport Tremujor 2012 |
| 2 | Dërguesi i dokumentit | **Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv** |
| 3 | Përmbajtja e Raportit | **Kapitulli 1:** Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bëre gjatë tremujorit të parë të vitit 2012<br><br>**Kapitulli 2:** Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare<br>2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Kyç të Performancës – operimi i sistemit dhe operimi i transmisionit<br>2.2. Raport i operimit të tregut<br>2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT<br>2.4. Çështjet rregullative<br>2.5. Shqyrtimi i performancës financiare<br>2.5.1. Pasqyrat financiare (Bilanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes, Realizimi i projekteve kapitale nga BK gjatë tremujorit të parë të vitit 2012)<br>2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare<br><br>**Kapitulli 3 :** Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore<br><br>**Kapitulli 4:** Kontratat/Transakcionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 nga burimet e KOSTT<br><br>**Shtojcë 1:** Raporti për funkcionimin e qeverisjes korporative |
| 4 | Data e Raportimit | |

# Hyrje

Raporti tremujori Janar - Mars 2012 përmban të gjitha elemente konform nënit 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport për tremujorin e sapo përfunduar ("tremujori përkatës") i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikat dhe Monitorim të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë tremujorit të parë të këtij viti si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transakcionet e konsiderueshme të tremujorit të parë, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet funkcionimin e qeverisjes korporative të KOSTT-it.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nënin 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087.

# 1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë tremujorit të parë 2012

## 1.1. Organizimi

Struktura organizative e KOSTT-it është e përbërë nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit.

Afarizmi i KOSTT zhvillohet nga 8 (tetë) Departamente, 3 (tri) Zyre të përbëra në strukturën e Drejtorisë Qendrore. Në strukturën e KOSTT janë të përfshirë edhe pozitat e Kryeshefit Ekzekutiv, 2 (dy) Zëvendës të KSHE, njeri me përgjegjësi për operim ndërsa tjetri për zhvillim, Sekretarit të Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Trezorit, si dhe Zyrtarit për Auditimin e Brendshëm.

Organizimi i KOSTT është bazuar në afarizmin themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, komercial, rregullativ, ligjor, marrëdhënieve me punëtorë, administrativ, zhvillimit të personelit, teknologjisë së informacionit dhe zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:

- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat
- Burimet Njerëzore dhe
- Prokurimit

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë
- Zyra për Komunikim dhe Relacionë me Publikun dhe
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mjedis

## 1.2. Numri i Punëtorëve

Me datën 1 Janar 2012 numri i punëtorëve në KOSTT ka qenë 242, ndërsa më 31 Mars 2012 numri i përgjithshëm i të punësuarve është 239.

Gjatë kësaj përiudhe ka pasur lëvizje të numrit të punëtorëve për këto arsye:

- 3 (tre) punëtorë janë pensionuar gjatë muajit janar dhe shkurt 2012

Nga numri i përgjithshëm i punëtorëve 239, prej tyre:

- 1 (një) punëtorë gjendet në pushim pa pagesë

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it



Bordi i Drejtorëve
Komisioni i Auditimit
Kryeshefi Ekzekutiv
Zyrtari i Auditimit të Brendshëm
Zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv për Operim
Zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv për Zhvillim
Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit
Sekretari i Kompanisë
Zyra e Komunikimit dhe Relacione me Publikun
Zyra e Zhvillimit dhe Planifikimit Afatgjatë
Operimi i Transmisionit
Operimi i Sistemit
Prokurimi
Financat dhe i Thesari
Operimi i Tregut
Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
Çështjet Ligjore dhe Rregullative
Burimet Njerëzore

# Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare

## 2.1. Raport për operimin e sistemit dhe transmisionit për Indikatorët Teknik të Performancës

### 2.1.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Janar-Mars 2012

| Muajt | Janar-Mars | | |
|---|---|---|---|
| MWh | E planifikuar | E realizuar | Real/Plan% |
| (1) TC Kosova A | 393 120 | 554 939 | 141,16 |
| (2) TC Kosova B | 1 060 899 | 1 040 762 | 98,10 |
| (3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B) | 44 661 | | |
| (4) HC Ujmani | 26 000 | 12 266 | 47,18 |
| (5) HC Lumbardhi | 4 199 | 2 679 | 63,81 |
| (6) = 1+2+3+4 Prodhimi në prag të transmisionit | 1 524 680 | 1 607 967 | 105,46 |
| (7) Devijimi | 13 761 | 22 756 | |
| (8) Eksporti | 0 | 53 691 | |
| (9) Importi | 233 680 | 217 337 | 93,01 |
| (10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim | 1 744 599 | 1 748 857 | 100,24 |
| (11) Distribucioni | 1 448 834 | 1 447 803 | 99,93 |
| (12) Ferronikeli | 162 000 | 129 038 | 79,65 |
| (13) Trepça | 6 655 | 6 636 | 99,72 |
| (14) Sharri | 12 000 | 4 189 | 34,91 |
| (15) Mihjet | 27 000 | 37 845 | 140,17 |
| (16) Konsumatoret e jashtem te KEK | 5 100 | 0 | 0,00 |
| (17) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45) | 44 661 | 93 073 | |
| (18) = 11+12+13+14+15+16+17 Kërkesa neto | 1 706 250 | 1 718 585 | 100,72 |
| (19) Humbjet në transmission | 38 349 | 30 272 | 78,94 |
| (20) =18+19 Kërkesa gjithsej | 1 744 599 | 1 748 857 | 100,24 |

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.

<u>Shpjegim:</u> (3) Energjia për shpenzime vetanake nga (TC A dhe TC B) e cila hyn në rrjetin e transmisionit është e barabartë me energjinë që termocentralet e marrin nga rrjeti i transmisionit për shpenzime vetanake (17). Rreshti (3) në tabelë në vlerat e realizuara është e përfshirë në pikën (6)- Prodhimi në prag të transmisionit.

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:



## Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Janar - Mars 2012 (GWh)



## Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

| Nr | Indikatori | | 2011 Janar-Mars 2011 | 2012 Janar-Mars 2012 | 2012/2011(%) | Caku | Komenti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T1 | * Energjia që hyn në transmision (GWh) | | 2405,95 | 2340,72 | 97,29 | Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këte as hyrjet totale në transmision | Caku nuk vendoset për këtë IKP, |
| T2 | Piku koincident (MW) | | 1109 | 1168 | 105,32 | Caku: 1100MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012). | Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 5,32 % ka qenë piku më i lartë në përiudhën Janar-Mars 2012 se sa Janar-Mars 2011. |
| T3 | Gjatësia totale e linjave (km) | 400 kV | 181,815 | 188,49 | 103,67 | = > 1 | Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit. |
| | | 220 kV | 231,882 | 231,882 | 100,00 | | |
| | | 110 kV | 727,6 | 764,94 | 105,13 | | |
| T4 | MVA-km | 400 kV | 239450 | 248249 | 103,67 | = > 1 | Caku është si në T3 |
| | | 220 kV | 77506 | 77506 | 100,00 | | |
| | | 110 kV | 80573 | 83209 | 103,27 | | |
| T5 | Kapaciteti i transformatorëve | 400-220;400-110 kV | 1500 | 1800 | 120,00 | = > 1 | Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri. |
| | | 220-110 kV | 1200 | 1200 | 100,00 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **T6** | Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC) | | | | | | I paaplikueshëm për shkak se KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E |
| **T7** | Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC | | | | | | I paaplikueshëm për shkak se KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E |
| **T8** | Pagesa për kongjestion | | | | | | KOSTT do të fillojë pagesën kur ATC (kapaciteti i disponueshëm) do të alokohet nga Operimi i Tregut/kontrollohet nga Operimi i Sistemit, për TTC[1] |
| **T9** | Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit) | | 25,61 | 80,94 | 316,05 | Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhën aktuale)/(AIT për periudhën e kaluar) < 1 | AIT (Koha mesatare e rënies) 25,61 minuta gjatë tre muajve, Janar-Mars 2011, ndërsa 80,94 minuta për periudhën e njëjtë 2012. Nuk ka një statistikë për një periudhë më të gjatë që të vendoset caku i vërtetë. |
| **T10** | Numri i ankesave për tension | | 1 | 0 | 0,00 | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtër. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur një ankesë për tension, nga Ferronikeli. |
| **T11** | Ankesat e zgjidhura për tension | Më pak se një javë | 1 | 0 | 0,00 | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për zgjidhjen e ankesave për tension: duhet që në kohë sa më të shkurtër që të jetë e mundur(< 1 javë) të shqyrtohet ankesa. |

[1] *TTC –Kapaciteti total që ka të bëjë me vlerën maksimale të programit të shkëmbimeve ndërmjet dy zonave kompatibile.*

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Më pak se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak(e). |
| | | Më shumë se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |
| T12 | Numri i ankesave për matje | | 0 | 0 | | | |
| T13 | Ankesat e zgjidhura për matje | Më pak se një javë | 0 | 0 | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për zgjidhjen e ankesave për matje: duhet që në kohë sa më të shkurtër që të jetë e mundur(< 1 javë) të shqyrtohet ankesa. |
| | | Më pak se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |
| | | Më shumë se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |
| T14 | Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë) | Import | 15,75 | 32,40 | 205,69 | 20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar | Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla. |
| | | Eksport | 16,03 | 31,88 | 198,92 | 20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar | |
| T15 | Humbjet në transmision (GWh) | | 40,39 | 30,27 | 74,95 | | Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 25,05% më të vogla në përiudhën Janar-Mars 2012 se sa në periudhën Janar-Mars 2011. |

AIT=(8760*60*ENS)/TE

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmited energy - ET- Energjia e transmetuar

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

*)Indikatori T1 Energjia që hyn në transmision (GWh) sipas dokumentit të aprovuar nga ZRrE "Indikatorët e Performancës Teknike", ka emërtimin Energjia e transmetuar.

### 2.1.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

| Nr | Indikatori | Niveli i tensionit | 2011 | 2012 | Krahasimi | Caku | Komenti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kV | Janar-Mars | Janar-Mars | 2012/2011 (%) | < = 1 | |
| T1 | Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi | 400 | **0.00** | **0.00** | 0 | > 1 | Performancë negative për shkak të këputjes së përçuesit së LP 184/1 Si në T-9 |
| | | 220 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **0.00** | **0.14** | 0 | | |
| T2 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë) | 400 | **0.00** | **0.00** | 0 | >1 | Performancë negative për shkak të këputjes së përçuesit së LP 184/1 Si në T-9 |
| | | 220 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **0.00** | **2.21** | 0 | | |
| T3 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta) | 400 | **0.00** | **0.00** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| T4 | Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi) | 400/220(110) | **0.00** | **0.00** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220/110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| T5 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë) | 400/220(110) | **0.00** | **0.61** | 0 | >1 | Performancë negative për shkak të shpërthimit të tercierit të AT2 në NS Prishtina 4 |
| | | 220/110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| T6 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta) | 400/220(110) | **0.00** | **0.00** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220/110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T7 | Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha | 400 | **0.00** | **0.01** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220 | **3.30** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **1.20** | **0.04** | 3.33 | | |
| T8 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë) | 400 | **0.00** | **4.25** | 0 | >1 | Performancë negative sepse eliminimi i prishjeve ka zgjatur më shumë. |
| | | 220 | **1.00** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **2.20** | **2.762** | 125.5 | | |
| T9 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta) | 400 | **0.00** | **0.00** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| T10 | Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha | 400 | **0.00** | **0.00** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220 | **2.77** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| T11 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë) | 400 | **0.00** | **0.00** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220 | **1.70** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| T12 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta | 400 | **0.00** | **0.00** | 0 | < = 1 | Performancë pozitive |
| | | 220 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |
| | | 110 | **0.00** | **0.00** | 0 | | |

## 2.2. Raport mbi operimin e tregut

### 2.2.1. Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku pjesa më e madhe e tregut është e rregulluar dhe mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Të drejtën e konsumatorit të kualifikuar e shfrytëzon Feronikeli por meqenëse nuk ka furnizues tjerë të licencuar Feronikeli është furnizuar nga furnizuesi publik me kontratë me çmim të rregulluar. Për shkak te mungesës se komkurrencës dhe furnizuesve të tjerë dhe sipas ligjeve te reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Është arritë marrëveshje midis KEK , Feronikelit dhe ZRrE qe Feronikeli të furnizohet nga KEK me çmim te rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet në këtë tremujor si raport i energjisë së konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar) në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë. Kjo përfshinë energjinë e përgjithshme që ka dalë nga transmisioni dhe energjinë që ka hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit.

Deri më tani janë realizuar rreth 30% të të hyrave të lejuara të KOSTT por pritet që kjo përqindje të ndryshojë me aplikimin e tarifave të reja.

Si rezulatat i kushteve më të favorshme klimatike në këtë kuartal kemi rënie të humbjeve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2011.
TLF (faktori i humbjeve) mesatare e realizuar në këtë tre-mujor është 1.0176, nga 1.023 sa ishte në të njëjtën periudhë në 2011 .

Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues të KOSTT, si shihet mbi 20.74% të rrjedhave fizike të energjjisë nëpër rrjetin transmetues, janë tranzit i energjisë për nevoja regjionale, dhe për këtë shërbim KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi i ITC nuk është duke u kompensuar por kompensohet EMS ( TSO e Serbisë).

Sipas estimimeve të KOSTT, energjia elektrike e reduktuar në këtë tre-mujor ështe mesatarisht rreth 6.14% e konsumit vendor, nga 5.48% sa ishte në periudhën e njëjtë në 2011.

Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në këtë tremujor ishte mesatarisht rreth 84.90%.

Portfolio energjetike e palëve në tregun me shumicë është paraqitur në Aneks.

**Tregu i rregulluar dhe pa-rregulluar**

Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues




Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision






## 2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT

| Nr | Emri i Projektit | Buxheti | Fincuar nga | Vlera e Kontratës | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktues | Realizimi:<br>(i.) Progresi,<br>(ii.) Rreziku dhe pengesat | Rekomandime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | *Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-1:</u> NS 400/110 kV Ferizaj 2* | 15,800,000.00 € | BKK | 13,656,000.00 € | 24.12.2009 | 23.10.2012 | SIEMENS (At) | (i.) Projekti është në fazën e periudhës garantuese njëvjeçare. | |
| | *Paket Projekti Ferizaj-2 <u>LOT-2</u>:LP ndërlidhëse 400 dhe 110 kV* | 7,500,000.00 € | ECLO | 6,105,000.00 € | 31.12.2009 | 30.10.2011 | UMEL (B&H) | (i.) Projekti është në fazën e periudhës garantuese njëvjeçare. | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | *Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekomi <u>LOT-1</u>:SCADA/EMS* | 8,500,000.00 € | BKK | 7,875,370.00 € | 31.12.2008 | 30.06.2011 | Alstom/Komtel (F/RKS) | (i.) Sipas planit dinamik projekti është lëshuar në punë me 30.06.2011, por jo i kompletuar. Ka përfunduar periudha e Disponueshmërisë së Sistemit. Është nënshkruar dhe lëshuar Certifikata e Pranimit Parcial të Përkohshëm (PPAC), më 04.11.2011, me ç'rast fillon edhe periudha garantuese njëvjeçare, për ato pjesë të projektit. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi është anagzhuar në eliminimin e vërejtjeve nga lista e raportit të komisionit për pranim teknik intern të KOSTT-it.<br>Me date 29.03.2012 dhe 30.03.2012, Komisioni për Pranim Teknik Intern i KOSTT-it, ka dalur për komisionimin e eliminimit të verejtjeve me ç'rast ka përgatitur raportin përkatës. | Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që janë paraqitur nga komisioni për pranim teknik intern, duhet të eliminohen brenda afatit të paraparë. |
| | *Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekomi <u>LOT-2</u>: Telekomi* | 9,500,000.00 € | BKK | 9,214,760.00 € | 31.12.2008 | 30.06.2011 | Enëgroinvest/Alstom(B&H/F) | (i.) Sipas planit dinamik projekti është pjesërisht i përfunduar dhe me 30.06.2011 sistemi SCADA/EMS dhe telekomi . Është nënshkruar deklarata për kompletimin e projektit nga ana e ALSTOM dhe KOMTEL për përfundimin e punimeve të projektit. Ka përfunduar periudha e Disponueshmërisë së Sistemit . Çertifikata e Pranimit të Përkoshëm (parcial) PPAC lëshohet për pjesët e përfunduara , me ç'rast fillon edhe periudha garantuese njëvjeçare, për ato pjesë të projektit. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi duhet të vazhdoj me përfundim të punëve konform kontratës dhe në eliminimin e vërejtjeve nga lista e raportit të komisionit për pranim teknik intern të KOSTT-it.<br>Me date 29.03.2012 dhe 30.03.2012, prape Komisioni për Pranim Teknik Intern i KOSTT-it, ka dalur për komisionimin e eliminimit të verejtjeve me ç'rast ka përgatitur raportin përkatës. | Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që do të paraqiten nga komisioni intern duhet të eliminohen brenda afatit garantues. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | *Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)* | 10.000.000,00 | ECLO | 6,308,920.00 € | 10.01.2011 | 09.07.2012 | KONCAR (Hr) | (i) Projekti është në fazën e implementimit. Qarqet sekondare për 5 fusha (3 110 kV si dhe 2 220 kV) janë të gatshme për lidhje në ormanët e mbrojtjes dhe sistmit komandues dhe monitorues të nënstacionit (obligim i kontraktuesit: konsorciumit Alstom/Komtel PE në kuadër te Projektit SCADA/EMS dhe Telekomi). Disa herë janë mbajtur takime teknike koordinuese me të dy kontraktuesit Koncar dhe Alstom/Komtel, por edhe me date 05.04.2012, me ç'rast të dy kontraktuesve iu bë e qartë se projekti duhet kompletuar në kohë, si dhe u njoftuan për "milestone" në projekt.<br>(ii.) Ka vonesa në projekt, dhe shkaktar i këtyre vonesave është mosperfomimi si duhet i kontraktuesit gjatë implementimit të projektit si dhe kushtet e vështira të motit gjatë sezonës dimërore. Kontraktuesi ka paraqitur planin e ri dinamik me vonesë prej dy muajsh (62 dite). Përveç kësaj, mund të ketë vonesa tjera, varësisht se sa është i gatshëm me staf kontraktuesi Alstom/Komtel PE të bëjë lidhjet e qarqeve sekondare, sipas planit dinamik të dërguar nga Konçar. Për planin dinamik të ketij projekti kontraktuesi i SCADA/EMS (Alstom/Komtel PE) ka qenë i njoftuar me kohë nga ana e KOSTT-it. | Kontraktuesit Koncar, në menyrë që të arrijë kohën e kompletimit të projektit, i është kërkuar të rris numrin e stafit profesional si dhe makinerinë që do të punojë në terren. |
| 4 | *Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3* | 2,389,000.00 € | KOSTT | 1.959.800.80€ | 01.06.2011 | 20.12.2011 | ELSA&UKAB (Si/RKS) | (i). Është vazhduar me demontimin e shtyllave të vjetra, mirëpo pasi që ende nuk kemi marr pëlqimin (lejen) nga Ministria e Ambientit dhe e Mjedisit, kemi kërkuar nga kontraktuesi që të ndalet me implementimin e projektit. Duhet theksuar se kontraktuesi ende nuk e ka sjell dizajnin/projektin për linjën 110 kV Trepçë-Vallaq, konfrom Ligjit për Ndërtim dhe Elaboratin e Shpronësimit, konform Ligjit për Shpronësime. | Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar/dizajni të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it, konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | (ii.) Projekti ka vonesa në implementim, për shkak se kontraktuesi nuk është duke performuar si duhet në raport me dizajnet/projektet që nevojiten për marrjen e Lejes Urbanistike dhe Ndërtimore sipas kërkesës së Ministrisë së planifikimit hapsinor. Për këto vonesa kontraktuesi është njoftuar zyrtarisht dhe i është tërhjekur vërejtja se për vonesat që janë shkaktuar nga ai, do të veprojmë konform kushteve të kontratës. | |
| 5 | *Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)* | 1,050,000.00 € | KOSTT | 1,397,094.32 € | 27.06.2011 | 27.07.2012 | UMEL (B&H) | (i). Është dërguar dokumentacioni për marrjen e lejes nga Ministria e Ambientit dhe të Mjedisit, pritet që kur të mirret leja të fillohet me implementimin e projektit. Në ndërkohë është bërë demontimi i disa paisjeve të vjetra nga NS Lipjani - 110/35 kV.<br>(ii). Projekti ka vonesa në implementim, si pasojë e mospërgatitjes siç duhet të dizjanit nga ana e kontraktuesit sipas regjimit të ri që Ministria e planifikimit hapsinor kërkon, konform Ligjit për Ndërtim dhe atë të Shpronësimeve. Ende nuk është siguruar Leja Urbanisitike dhe ajo Ndërtimore për këto objekte. | Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar/dizajni të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it, konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet. |
| 6 | *Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3* | 250,000.00 € | KOSTT | 168,880.32 € | 11.07.2011 | 02.01.2012 | KONCAR-KET (Hr) | (i). Projekti është kompletuar dhe është bërë Pranimi Teknik Intern.<br>(ii.) Projekti ka pasur vonesa, si pasojë e mossigurimit të kushteve për punë nga ana e Operimit të Sistemit. | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | *Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)* | 150,000.00 € | KOSTT | 51,976.60 € | 25.09.2011 | 17.12.2011 | ELEGANCA (RKS) | (i) Kanë përfunduar punët implementuese në Linjën 110kV, nr.1801, në linjen 179/1 kanë përfunduar punët pjesërisht 80%, në linjën 126/4 nuk kanë filluar punët akoma për shkak të pa mundësisë së krijimit të kushteve për punë për kontraktuesin;<br>(ii.) Ka vonesa në projekt si pasojë e pamundësisë së krijimit të kushteve për punë - shkyçjet e linjave. | |
| 8 | *Ndarja e zbarrave në dy seksionë në NS Gjilani 1 dhe NS Therande* | 150,000.00 € | KOSTT | 36,951.57 € | 09.08.2011 | 27.01.2012 | Ukab (RKS) | (i) Projekti është në fazën e implementimit. FAT (Pranimi Teknik në Fabrikë) është bërë për ndarës si dhe liferimi i tyre do të ndodh shumë shpejt.<br>(ii). Ka vonesa në projekt për shkak të moskrijimit të kushteve për punë kontraktuesit - shkyçjet totale të stabilimenteve gjatë sezonës dimërore dhe tash për NS Gjilani 1 dhe NS Therandë | Është kërkuar nga Departamenti i Operimit të Sistemit për gjetjen e kohës së përshtatshme për krijimin e kushteve për punë për kontraktuesin. |
| 9 | *Rialokimi i linjës 110kV , nr.1806 NS Gjakova 1 - Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1* | 4,000,000.00 € | KOSTT | 3,267,253.00 € | 02.12.2011 | 29.06.2012 (120 ditë punë) | Ukab (RKS)/ELSA (Si) | (i) Projekti është ende në fazën fillestare; ende nuk janë dërguar dizajnet bazike dhe ato detale, që janë parakusht për sigurimin e Lejes Urbanistike dhe Ndërtimore për ndërtimin e linjës së dyfishtë 110 kV si dhe të zgjerimit të nënstactionit NS Gjakova 1. Është realizuar FAT (Pranimi Teknik në Fabrikë) për pajijset: ndarës, ndërprerës të fuqisë dhe transformatorë matës. Liferim i tyre është bërë.<br>(ii). Projekti ka vonesa të konsiderueshme në dorëzimin e dizajneve mbi bazën e të cilave do të zhvilloheshin aktivitetet administrative për lejet e ndërtimit dhe shpronsimeve, të shkaktuara nga ana e kontraktuesit, si pasojë e mospërformancës sipas kushteve të kontratës. Tek me date 18.04.2012 është dërguar plani i ri dinamik i realizimit të projektit, ku shihet vonesa e projektit; kompletimi i projektit deri në fund të Dhjetorit 2012.<br>Procesverbali i miratuar nga BD në takimin e dt.30.04.2012 detajisht sqaron veprimet e mëtejme. | Kontraktuesit i është kërkuar disa herë zyrtarisht që t'i përmbahet kushteve kontraktuale, po ende nuk ka ndonjë rezultat në këtë drejtim. Për situatën e tillë të krijuar është njoftuar edhe Departamenti i Prokurimit dhe menaxhmenti me i lartë.<br>Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar/dizajni të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it, konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | *Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV - Kosova B* | 250,000.00 € | KOSTT | 272,409.00 € | 12.12.2011 | [illegible] (150 ditë | Monting (RKS) | (i) Projekti është në fazën e implementimit. Dizajnet bazike dhe detale janë duke u kompletuar/aprovuar nga ana e KOSTT-it. Është mbajtur FAT (Pranimi Teknik në Fabrikë) për kthinat 6.3 kV. Liferimi i tyre do të ndodh shumë shpejt. | |
| 11 | *Rehabilitimi i pajisjeve të tenisonit te larte (TL) 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1* | 1,150,000.00 € | KOSTT | 960,031.00 € | 18.02.2012 | 17.12.2012 | Enbi-Power (Al) | (i) Projekti është në fazën e implementimit. Janë duke u komentuar/aprovuar dizajnet bazike dhe detale për pajisjet që do të ndërrohen. | Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar/dizajni të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it, konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet. |
| 12 | *Instalimi i dy fushave te reja te linjave 110kV në NS Prizreni 2* | 600,000.00 € | KOSTT | 551,998.00 € | 17.02.2012 | 03.08.2012 | Ukab (RKS) | (i) Projekti është në fazën e implementimit. Janë duke u komentuar/aprovuar dizajnet bazike dhe detale për pajisjet që do të ndërrohen. | |
| 13 | *Rehabilitimi i stabilimenteve te TL në NS Gjakova 2* | 1,400,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). Projekti është në fazën e përgatitjes. Deri në fund të Prillit 2012 pritet të dorëzohen termat e referencës dhe Specifikimet Teknike në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit | |
| 14 | *Rehabilitimi i stabilimenteve te TL në NS Prizreni 3* | 1,400,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). Projekti është në fazën e përgatitjes. Deri në fund të Prillit 2012 pritet të dorëzohen termat e referencës dhe Specifikimet Teknike në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | *Furnizimi me softuerin E-Plan* | 20,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike janë përgatitur me kohë dhe janë dorëzuar në Departamentin e Prokurimit me 23.01.2012, për procesin e tenderimit.<br>Projekti eshte anuluar. Njoftimi per Anulim eshte bere per shkak se të gjitha ofertat kanë tejkaluar subsatncialisht buxhetin. | |
| 16 | *Asfaltimi i rruges se çasjes për në NS 400/110 kV - Peja 3* | 150,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike janë përgatitur me kohë dhe janë dorëzuar në Departamentin e Prokurimit me 31.01.2012, për procesin e tenderimit.<br>Për këtë projekt është përzgjedhur fituesi dhe është shpallur Njoftimi mbi dhënien.<br>Nënshkrimi i kontratës (nëse nuk do të ketë ankesa), pritet të bëhet me datën 28.05.2012. | |
| 17 | *Ndertimi i rrethojes se re në NS 400/220 kV - Kosova B dhe Instalimi i ndriçimit përgjatë saj* | 180,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike janë përgatitur me kohë dhe janë dorëzuar në Departamentin e Prokurimit me 22.03.2012, për procesin e tenderimit.<br>Projekti është në pritje, (nuk është publikuar) për arsye se buxheti i paraparë nuk është i mjaftueshem në bazë të kërkesave të specifikimit teknik. | |
| 18 | *Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo* | 100,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). Projekti është në fazën e përgatitjes. Deri në fund të Prillit 2012 pritet të dorëzohen termat e referencës dhe Specifikimet Teknike në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit | |

## 2.4. Çështjet rregullative

### Shqyrtimi i Gjashtë i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE6)

Në fillim të muajit janar KOSTT ka pranuar nga ZRRE njoftimin për planet e ZRrE lidhur me procesin e shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike(SHTE6) të cilat pritet të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2012. Procesi i shqyrtimit të tarifave përfshinë përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që të licencuarit në shqyrtim i lejohet të mbledhë për shërbimet e rregulluara që ofron. MAR-i i përcaktuar me këtë shqyrtim pritet të hyjë në fuqi që nga data 1 prilli 2012.

Sipas planit të pranuar nga ZRrE, me datë 17 janar KOSTT ka dorëzuar aplikacionin për të hyrat e lejuara për periudhën duke filluar nga data 1 prill 2012. Në ditët në vijim kanë vazhduar konsultimet/takimet si dhe disa plotësime dhe sqarime shtesë lidhur me aplikacionin.
Me datë 27 shkurt kemi pranuar Raportet Konsultative të Zyrës së Rregullatorit për Energji, lidhur me aplikacionet e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT). Këto Raporte kanë për qëllim të pranimit të komenteve nga KOSTT dhe KEK si dhe nga palët e interesit për vlerësimet e ZRrE-së. Raporti përmban edhe propozimet preliminare për të Hyrat e Lejuara për KEK-un dhe KOSTT-in, të cilat do të shërbejnë si bazë për përcaktimin e tarifave.

KOSTT ka analizuar Raportin Konsultativ për KOSTT dhe për KEK dhe i ka përgatitur komentet.. Me datë 12 shkurt janë dërguar në ZRrE komente ndaj Raportit Konsultativ për KOSTT dhe ndaj Raportit Konsultativ për KEK..

### Vendimi i ZRrE lidhur me kontestin e ngritur nga KOSTT sh.a. ndaj KEK sh.a.

Me datë 28 shkurt 2012, KOSTT ka pranuar nga ZRrE vendimin V_400 të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, nga mbledhja e mbajtur me datë 29 dhjetor 2011, lidhur me kontestin e ngritur nga KOSTT sh.a. ndaj KEK sh.a. lidhur me çështjet : refuzimi i pagesës për shërbimet e transmisionit dhe kthimi i faturave për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2010, mospagesën e faturave t bashkërenditjes për vitin 2008 dhe 2009 dhe mosnënshtrimin e Marrëveshjeve të Kyçjes KOSTT - KEK për kyçjet ekzistuese.

Në bazë të njoftimit të lëshuar nga ZRrE për fillimin e procesit për modifikimin e Licencave në përputhje me kërkesat e reja të përcaktuara me Legjislacionin e ri në

Kosovë, KOSTT ka përgatitur komente dhe i ka dërguar në ZRrE me date 07 mars 2012.

Me datë 29.02.2012, KEK sh.a. përmes të shkresës përcjellëse ka kthyer faturat për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011.

Me datë 12 mars KOSTT ka njoftuar ZRrE-në lidhur me shkresën e KEK-ut t datës 29.02.2012 për kthimin e faturave për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011.

Me datë 28 shkurt 2012, KOSTT ka iniciuar pranë ZRrE-së kontestin kundër KEK Sh.a për mospagesat e vitit 2011.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Energji Elektrike KOSTT pa përgatitur dhe ka dërguar në ZRrE drafin e parë të Metodologjive Tarifore për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit.

## 2.5. Shqyrtimi i përformancës financiare

## 2.5.1. Draft Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES

| | Janar-Mars /2011 | Janar-Mars /2012 | % |
|---|---|---|---|
| ASETETE JO QARKULLUESE | 87,487,319 | 110,216,882 | 125.98% |
| Prona, Fabrika dhe Paisjet | 68,695,319 | 108,759,783 | 158.32% |
| Investimet ne vijim | 18,792,000 | 1,457,099 | 7.75% |
| ASETET QARKULLUESE | 35,803,047 | 31,273,005 | 87.35% |
| Stoqet, pjesët rezervë dhe veglat | 916,337 | 1,565,666 | 170.86% |
| Kërkesat | 10,032,777 | 10,736,880 | 107.02% |
| Kredi, avanse dhe depozita | 6,890,671 | 1,289,139 | 18.71% |
| Tatimi i parapaguar | 135,417 | 206,195 | 0.00% |
| Paraja dhe Bilanci Bankar | 17,827,846 | 17,475,125 | 98.02% |
| TOTALI I MJETEVE | 123,290,366 | 141,489,887 | 114.76% |
| KAPITALI I AKSIONARËVE | 45,350,999 | 54,164,434 | 119.43% |
| Kapitali Aksionar | 25,000 | 25,000 | 100.00% |
| Kapitali i trashëguar | 28,346,963 | 38,176,268 | 134.67% |
| Fitimi i mbajtur | 14,679,099 | 15,367,648 | 104.69% |
| | | | 0.00% |
| Fitimi aktual | 2,299,937 | 595,518 | 25.89% |
| OBLIGIMET JO QARKULLUESE | 69,266,636 | 75,713,931 | 109.31% |
| Të hyrat e shtyera | 69,266,636 | 75,713,931 | 109.31% |
| OBLIGIMET QARKULLUESE | 8,672,731 | 11,611,522 | 133.89% |
| Obl.nga tregtia dhe obl.tjera | 8,672,731 | 11,611,522 | 133.89% |
| TOTAL BURIMET E MJETEVE | 123,290,366 | 141,489,887 | 114.76% |

## DRAFT PASQYRA E FITMIT DHE HUMBJES

| | Nota | Plani Janar-Mars 2011 | Realiz. Janar-Mars 2011 | % real/plani 2011 | Plani Janar-Mars 2012 | Realiz. Janar-Mars 2012 | % real/plani 2012 | % realiz 2012/2011 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Të hyrat nga tarifa | 15 | 5,136,087 | 5,311,924 | 103.4% | 3,454,928 | 3,521,787 | 101.9% | 66.3% |
| Të hyrat tjera | 16 | 730,000 | 1,004,848 | 137.7% | 1,237,500 | 1,325,798 | 107.1% | 131.9% |
| **Të hyrat totale** | | **5,866,087** | **6,316,771** | 107.7% | **4,692,428** | **4,847,585** | 103.3% | 76.7% |
| Shpenzimet e personelit | 17 | 667,838 | 637,186 | 95.4% | 798,021 | 742,138 | 93.0% | 116.5% |
| Shpenzimet e materialit | | 13,000 | 7,940 | 61.1% | 13,000 | 9,476 | 72.9% | 119.3% |
| Kompenzimet Bordi i Drejtorve | | 11,250 | 35,765 | 317.9% | 11,250 | 10,219 | 90.8% | 28.6% |
| Amortizimi | 4 | 1,560,000 | 1,661,038 | 106.5% | 1,475,000 | 2,102,645 | 142.6% | 126.6% |
| Energjia,telofoni, uji | | 57,195 | 69,840 | 122.1% | 69,695 | 78,653 | 112.9% | 112.6% |
| Riparime dhe mirëmbajtje | 18 | 188,129 | 54,708 | 29.1% | 327,000 | 165,047 | 50.5% | 301.7% |
| Derivate dhe lubrifikante | | 23,301 | 18,863 | 81.0% | 25,500 | 20,264 | 79.5% | 107.4% |
| Medicina,siguria dhe transpor | 20 | 78,000 | 76,053 | 97.5% | 77,500 | 33,179 | 42.8% | 43.6% |
| Shpenzimet tjera operative | 19 | 300,061 | 86,696 | 28.9% | 311,320 | 177,406 | 57.0% | 204.6% |
| Kompenzimet tjera. | | 13,750 | 7,603 | 55.3% | 13,750 | 16,989 | 123.6% | 223.4% |
| Humbjet në bartje | 21 | 1,265,233 | 1,361,143 | 107.6% | 1,291,243 | 896,051 | 69.4% | 65.8% |
| Rregullimi sekondar | | 400,000 | | | 400,000 | | 0.0% | |
| **Shpenzimet totale** | | 4,577,756 | 4,016,834 | 87.7% | 4,813,279 | 4,252,067 | 88.3% | 105.9% |
| **Fitimi para Tatimit** | | 1,288,331 | 2,299,938 | | (120,851) | 595,518 | | |
| Tatimi në fitim | 22 | | | | | | | |
| **Fitimi për periudhë** | | 1,288,331 | 2,299,938 | | (120,851) | 595,518 | | |

**Shpjegim:** Nëse KOSTT nuk do të kishte pasur të hyra tjera pos KEK-ut, atëherë kishte me qenë në humbje për 700 mijë.€

## 2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare

IKP-të financiare të zgjedhura për të paraqitur përformancën financiare të KOSTT-it, janë të matshëm në baza vjetore dhe në baza kuartale. Indikatorët e paraqitur në këtë tabelë janë të matshëm në baza kuartale.

| Treguesit | I-III 2011 | I-III 2012 | Spjegimet |
|---|---|---|---|
| **T1. Fitimi operativ margjinal** = Fitimi nëto /gjithësejt të hyrat | 0.4 | 0.1 | Qëllimi është që të jetë mbi zero.<br>Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionët vijuese.<br>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj.<br>Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë. |
| **T2. Treguesi i qarkullimit** = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese | 4.1 | 2.7 | Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtëra, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtëra. Optimalja e këtij treguesi është **1.5.** |
| **T4. Mbulimi i shp.operative** = gjith.të hyrat/shpenzimet operative | 1.6 | 1.1 | Tregon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve operative të realizuara.Treguesi duhet të jetë **më i madh ose** =1 |
| **T5. Mbulimi i të hyrave** = gjiths.të hyrat/ shpenzimet e lejuara | 1.7 | 1.0 | Treguesi duhet të jetë **më i madh ose** =1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **T6. Mbulimi i shp. të lejuara** = shpenzimet e lejuara/gjithësejt të hyrat | 0.6 | 1.0 | Treguesi duhet të jetë **më i vogël se 1 ose** =1 |
| **T7.Gjith.të hyrat ndaj të hyr.të lej** = gjiths.të hyrat e rregulluara/të hyrat e lejuara | 1.2 | 1.0 | Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara.Treguesi duhet të jetë =1. |
| **T12. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara** | 2.1 | 2.8 | Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZRrE-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 2.8 m €/GWh.<br>Ky indikator tutje analizohet duke iu referuar treguesit T14, që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 2.5 m €/GWh. |
| **T13. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara** | 3.1 | 2.7 | Paraqet të hyrat për njësi.<br>Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike |
| **T14. Shpenzimet totale për njësi**=shp.totale/GWh e transmetuara | 2.3 | 2.5 | Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike |

## 3. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

| Nr | Lënda nr. | Pranë | Objekti i kontestit | Vlera e kontestit | Statusi | Statusi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lënda Civile nr. 2248/03 | Gjykata Komunale në Prishtinë | dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës | 92,000.00 | Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës | Seanca e caktuar për dt.14.07.2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ia ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesëpadinë e Paditësit si të pabazë.Pritet Akgjykimi. | Seanca 01.04/11, shtyhet,...dhe seanca e dt.21.04 per dt.12.05/11.Gjykata Pjesrisht aprovon kërkesë padinë në vlerë 5000€.Ankesa e KOSTT-it në shkallë të II-të. |
| 2 | Lënda penale nr.326/05 | Gjykata Komunale në Kaçanik | vjedhje | 2,370.00 | Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01; shtyhet 30.03.2009 | Seanca përfundimtare me dt.17.03/09, është mbajtur Aktgjykimi.- është pranu, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009) | Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer. |
| 3 | Lënda Civile nr.85/05 | Gjykata Komunale në Prishtinë | kompensim i dëmit | 50,000.00 | Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008 | Seanca e rradhës është caktuar për dt.10.02.2009, Mbahet seanca përfundimtaredt.11.06.2009.Refuzohet Kërkesëpadia e Paditësit. | Lënda me Ankesë në GjQ. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Lënda civile C1.nr.505/07 | Gjykata Komunale në Prishtinë | pagesa e kamatës ligjore | nuk ka | Përfaqësuesi i KEK-ut, ka refuzuar pjesëmarrjen në seanca pa prezencën e KOSTT-it. | Është caktuar seanca me dt.01.04.2009, shtyhet. KOSTT parashtron Ankesë ne GjQ-Pr, kundër Aktgjykimit C1 505/07. Seanca e rradhës, dt.06.05.2010. | Aktgjykimi nuk është i formës së prerë |
| 5 | Lënda penale nr. 2406/ 06 | Gjykata Komunale në Prishtinë | vjedhje | 15,398.00 | Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por nuk është bërë akoma i plotfuqishëm | Nuk kemi njoftim ende për formën e prerë. | Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi nuk i është dorëzuar të Paditurve, nga dt12.06, do t'i dorëzohet me polici |
| 6 | Lënda penale nr.320/06 | Gjykata Komunale në Kaçanik | vjedhje e rëndë | 9,120.00 | Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008 | Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi | Aktgjykimi me Ankesë, ne GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010. |
| 7 | Lënda penale 284/06 | Gjykata Komunale në Lipjan | vjedhje e rëndë | Nuk është përcaktuar | KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishme (vlera e kontestit) | | Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut. |
| 8 | Lënda civile nr. 409/06 | Gjykata Komunale në Prishtinë | Lirimi i banesës | nuk ka | Seanca e rradhës nuk është mbajtur, pritet caktimi i seancës tjetër | Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata me dt.04.01/10 (ditë pushimi). | Seanca e rradhës nuk është caktuar ende. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Lënda civile nr.511/00 | Gjykata Komunale në Prishtinë | lirimi i lokaleve në Kurriz | nuk ka | Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT-in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë | Aktgjykimi është marrë, në proces është propozimi për ekzekutim. | Ende nuk është kryer. (Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të Lokaleve). Lënda meAnkesë GjQPr. KOSTT, ka parashtrua Urgjencë GJQarkut-PR. |
| 10 | Lënda civile nr. 2168/04 | Gjykata Komunale në Prishtinë | lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz | nuk ka | Seanca e rradhës u caktua për datën 19.11.2008 | Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit. | Seanca e rradhës me dt.17.04/09, (Përfaqëson KEK-u). Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata. KOSTT parashtron Urgjencë në vazhdimin e çështjes GjK-Pr. |
| 11 | Lënda civile C.nr.588/08 | Gjykata Komunale në Gjakovë | Kompenzim dëmi | 10000 | Seanca u caktua për dt.19.01.2009 | Seanca e rradhës në afat të pacaktuar | KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009.Në precizim të Padisë KOSTT dt.27.03.2012, parashtron përgjigje në Padi të C.nr.588/08 |
| 12 | C.156/09 | Gjykata Komunale Prizren | Kompenzim dëmi | | I parashtruar me dt.11.03/09. | | Pritet caktimi i seancës së radhës. |
| 13 | Lëndë civile , Padi | Gjykata Komunale Ferizaj | kompenzimi i dëmit | 200,00€ | Padia e dorëzuar në Gjykatë ,26.06/09 | Pritet caktimi i seancës. | Pritet caktimi i seancës. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | C.nr.1559/06 | Gjykata Komunale Prishtinë | pagesa e Rentës. | | KEK ka paguar - Qershor/2006. | Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10 | KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv. |
| 15 | C.nr. 270/07 | Gjykata Komunale Podujevë | Kompenzim dami | 100.000,€ | KOSTT- I padituri III-të (Tretë) | seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorzimi i shkresave të lëndës KOSTT-it | Seanca e radhës sipas ftesës. |
| 16 | C.nr.218/11 | Gjykata Komunale Ferizaj | Pengim Posedi | 500 € | KOSTT- ka parashtrua Përgjigje në Padi sipas Aktvendimit të Gjykatës | Seanca e dt. 20.06/11, shtyhet me 04.07; shtyhet me 05.09/11.Seanca e radhës dt.27.10/11 | Lënda e kryer në Shkallën e I-rë. KOSTT-parashtron Ankesë Gj.Qarkut-PR. |
| 17 | C.nr.503/11 | GJYKATA Komunale Pejë | Pengim Posedi | nn | Sipas kërkesës së Gjykatës KOSTT ka parashtrua precizimin e Padisë. | Pritet ftesa për seancë(para seancës sqarime me Gjyqtarin) | Lënda e aktivizuar nga Gjykata. Pritet caktimi i gjykimit nga Gjykata kompetente dhe përcaktimi i vlerës së kontestit. |
| 18 | C.nr.2255/06 | GjK-Prishtinë | Kompenzim dami | nn | Sipas kërkesës së të Atorizuarit të Paditëses me zgjerim të Padisë | Përgjigja në Padi sipas Akt. Gjyqësore u dorëzua më12.11.2011. | Seanca Gjyqsore sipas ftesës. Pritet caktimi i gjykimit nga Gjykata kompetente dhe përcaktimi i vlerës së kontestit. |
| 19 | C.nr.0571/2011 | GjK-Skenderaj | Anulim i marrëveshjes | 10, 000.00 € | Përgjigje në Padi dt.27.01. | Pritet ftesa për séance | Lënda e aktivizuar nga Gjykata. |

## 4. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 nga burimet e KOSTT

| Departmenti | Lloji i Prokurimit | Emri I Projektit | KONTRAKTORËT | Vlera e Kontratës | Vlera e Realizuar e Kontrates | Vlera e mbetur për realizim | Nr. I Protokolit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Mini konkurrenca | Furnizim me Softuer-Ftesa për Ofertim Nr1 | PPC IT | 290,687.12 € | 283,228.47 € | 7,458.65 € | nr.67 dt.16/03/2012 |
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Kuotim çmimesh | Furnizim me Material Zyrtar | TT OFFICE | 9,950.00 € | 3,037.11 € | 6,912.89 € | nr.40 dt.07.02.2012 |
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Kuotim çmimesh | Furnizim me Aksesorë | PPC IT | 9,900.00 € | 1,461.02 € | 8,438.98 € | nr.59 dt.23.02.2012 |
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Kuotim çmimesh | Furnizim me Toner | ACE OFFICE | 9,900.00 € | 6,220.13 € | 3,679.87 € | nr.45 dt.09.02.2012 |
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Kuotim çmimesh | Furnizim me Material Higjienik | Capital Ring | 9,805.48 € | - € | 9,805.48 € | nr.52 dt.16.02.2012 |
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Kuotim çmimesh | Përgatitja e Projektit për aklimatizim dhe ventilim në Ndërtesën Afariste të KOSTT-it | Proterm | 9,500.00 € | 9,500.00 € | - € | nr.15 dt.30.01.2012 |
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Kuotim çmimesh | Renovimi i Fasadës së Objektit të NS Kosova B me punët përcjellëse | Rexha shpk | 9,399.00 € | - € | 9,399.00 € | nr.11 dt.26.01.2012 |
| Zyra e Zhvillimit dhe Planifikimit Afatgjatë | procedure e negociuar | Mirëmbajtja e 5 Licencave të Softuerit Profesional PSS/E për vitin 2012 | SIEMENS Germany | 8,160.00 € | - € | 8,160.00 € | nr.105 dt.28.03.2012 |
| Departamenti i Burimeve Njerëzore | Kuotim çmimesh | Furnizim me Letër Toaleti për Duar | UNISERVIS | 5,000.00 € | 1,024.86 € | 3,975.14 € | nr.44 dt.08.02.2012 |
| Departamenti i OS | Kuotim çmimesh | Furnizim me Antena të Radiolidhjeve dhe Instalimi në veturat e KOSTT, Montimi dhe lidhja e Pajisjeve në Qendrën Monitoruese të Radiolidhjeve | Elting | 4,454.49 € | - € | 4,454.49 € | nr.64 dt.01.03.2012 |
| | | | TOTALI | 366,756.09 € | 304,471.59 € | 62,284.50 € | |

# Shtojca 1: Raport mbi funkcionimin e Qeverisjes Korporative të KOSTT-it

Raporti mbi funcionimin e Qeverisjes Korporative përfshinë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, bazuar në Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Statutin e Kompanisë dhe Rregulloren e Punës së Bordit. Ky Raport gjithashtu përfshinë edhe punën e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera të themeluara nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it.

Raporti mbi funcionimin e Qeverisjes Korporative përfshinë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, bazuar në Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Statutin e Kompanisë dhe Rregulloren e Punës së Bordit. Ky Raport gjithashtu përfshinë edhe punën e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera të themeluara nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it.

Për periudhën raportuese Janar – Mars 2012 Bordi ka mbajtur 2 (dy) mbledhje të rregullta, kurse Komisioni i Auditimit gjithashtu i ka mbajtur 2 (dy) mbledhje të rregullta. Gjatë kësaj periudhe Komisionet tjera (Komisioni i Bordit për projekte Kapitale dhe Komisioni i Bordit për Linjën 400kV Kosovë –Shqipëri) nuk janë takuar. Mbledhjet e tyre priten nga prilli e tutje, bazuar në implementimin e projekteve për të cilat janë themeluar.

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit janë mbajtur në periudhat kohore sipas Planit të aprovuar të Punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2012.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të rëndomta dhe përfshijnë: vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës, aprovimin e procesverbaleve nga mbledhjet paraprake të Bordit të Drejtorëve dhe të Komisioneve, raportin nga mbledhja e Komisionit të Auditimit dhe Raportin e Kryeshefit Ekzekutiv.

Mbledhjet në vijim janë paraqitur sipas datës së mbajtjes së tyre.

## 1. Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 25/12 e dt

Komisioni i Auditimit me datën 6 Janar 2012 ka mbajtur mbledhjen e rregullt.
Komisioni ka shqyrtuar Raportin tremujor të KOSTT-it për periudhën raportuese Tetor – Dhjetor 2011. Komisioni ka vlerësuar se Indikatorët e performancës tregojnë trend pozitiv dhe nuk ka diçka që mund të potencohet krahasuar me periudhën paraprake raportuese. Komisioni ka kërkuar

shpjegim për disa pjesë të raportit dhe ka dhënë sugjerime për disa modifikime të nevojshme.
Në lidhje me raportin tremujor KOSTT ka informuar Komisionin se edhe për tetor, nëntor dhe dhjetor 2011 KEK-u ka refuzuar të pranoj faturat e KOSTT-it dhe të bëj pagesën për shërbime të transmisionit. Në lidhje me kontestin të cilin KOSTT-i e ka iniciuar në ZRrE për shkak të mospranimit (kthimit) të faturave nga KEK-u dhe mospagesën nga KEK-u, Menaxhmenti i KOSTT-it ka informuar Bordin se ZRrE ka vendosur në lidhje me kontestin por pritet Vendimi i ZRrE-së me shkrim.

Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit dhe diskutimit rreth raportit për tremujorin Tetor-Dhjetor 2011, ka propozuar që raporti t'i rekomandohet Bordit për shqyrtim dhe aprovim.

Komisioni i Auditimit e ka vlerësuar draft Planin e Punës të Bordit dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2012 të propozuar nga Sekretari i Kompanisë. Komisioni ka sugjeruar disa modifikime dhe ka rekomanduar që ky plan t'i dërgohet Bordit për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e ardhshme të Bordit.

Komisioni gjithashtu ka shqyrtuar edhe Raportin e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, ku raportohet për aktivitete audituese në KOSTT. Zyrtari ka potencuar se është i kënaqur me performancën e shumicës së sektorëve dhe departamenteve në KOSTT.

## 2. Mbledhja e Bordit të Drejtorëve nr. 25/12 e datës 10.02.2012

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka shqyrtuar Raportin tremujor për periudhën raportuese Tetor – Dhjetor 2011. Raporti ka përmbajtur komentet nga Komisioni i Auditimit. Performanca e KOSTT-it është mbi caqet e planifikuara. Indikatorët kyç tregojnë performancë pozitive, vetëm indikatorët T1 dhe T2 tregojnë perfomancë negative për shkak të ndikimeve të jashtme, të spjegura në Tabelën e IKP-ve. Pas diskutimit dhe shqyrtimit si dhe shpjegimit të pikave në interesim të BD, u konstatua se KOSTT gjatë kuartalit të fundit të vitit 2011 (Q4/2011) ka treguar një performancë të lartë dhe i njëjti është aprovuar.

Bordi gjithashtu ka shqyrtuar draft Planin e punës së Bordit dhe të Komisionit të Auditimit për vitin 2012 të propozuar nga Sekretari i Kompanisë dhe u pajtua me përbërjen e tij, numrin dhe qëllimin e mbledhjeve. Mbledhjet janë përcaktuar bazuar në kërkesat ligjore nga Ligji për Ndërmarrjet Publike. Pas vlerësimit Plani u aprovua nga Bordi.

Bordi në vazhdim të mbledhjes ka shqyrtuar kërkesën për sigurimin e mjeteve buxhetore për riparimin e dëmeve në Ndërprerësit e Fuqisë NF 400 kV në NS 400/220 kV Kosova B dhe blerjen e një ndërprerësi 400 kV për fushën gjeneratorike B1 në NS Kosova B. Kjo rritja e buxhetit_do të përdoret për riparimin e dëmeve të shkaktuar me rastrin e eksplodimit me datën 6.01.2012. Si dëshmi të nevojës për rritjen e buxhetit janë dorëzuar edhe arsyetimet teknike të dt. 26.012012 dhe

dokumenti "Vlerësimi i dëmeve në pajisje" i datës 23.01.2012, numri i protokollit 45 i përgatitur nga Komisioni Profesional për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në pajisje nga moti i ligë me datën 6.01.2012. Njëkohësisht, KOSTT ka ushtruar edhe kërkesën për blerje të një ndërprerësi 400 kV për fushën gjeneratorike B1 në TS Kosova B në vlerë prej 110,000 Euro. Në total është propozuar që të bëhet rritja e buxhetit në vlerë prej 161,000 Euro, e cila edhe është aprovuar nga Bordi si e arsyeshme.

### 3. Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 26/12 e dt. 20.02.2012

Komisioni i Auditimit në mbledhjen e mbajtur më 20.02.2012 ka shqyrtar Draft Elaboratin e regjistrimit të pasurisë së KOSTT-it për vitin 2011.
Komisioni i regjistrimit të pasurisë ka përfunduar punën konform procedurës së aprovuar për regjistrimin e pasurisë. Regjistrimi u bë me kohë dhe janë mbajtur takime dhe konsultime me koordinatorët e komisioneve.
Elaborati paraqet një pasqyrë mbi të gjitha asetet si dhe për asetet që janë propozuar për qitje jashtë përdorimit.
Komisioni i Auditimit ka konstatuar se Elaborati është një material i përgatitur mirë, i përpiluar me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe se Elaborati është një ndër dokumentet themelore për përpilimin e llogarisë përfundimtare të ndërmarrjes, i cili ka vlerë të posaçme dhe si i tillë ti rekomandohet BD për aprovim.

### 4. Mbledhja e rregullt e Bordit të Drejtorëve nr. 26/12

Me datën 23 Shkurt 2012 Bordi ka mbajtur mbledhjen e tij nr. 26/12.
Bordi ka shqyrtuar Elaboratin e regjistrimit të pasurisë të KOSTT-it për vitin 2011 duke vlerësuar se Elaborati është përgatitur konform standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Komentet e Komisionit të Auditimit janë përfshirë në Raport dhe Bordi i Drejtorëve e ka aprovuar. Bordi i ka propozuar shërbimeve përkatëse të KOSTT-it që të bëjnë regjistrimet e duhura me sugjerimet që u dhanë gjatë mbledhjes së Bordit.

Bordi ka vlerësuar kërkesën e KOSTT-it për ndërrim të destinimit të lokalit në Kastriot. Komisioni u informua se lokali i KOSTT-it në Kastriot, dikur ka qenë zyre, ndërsa në vitin 1990 serbët ia kanë ndërruar destinimin, kështu që i kanë shndërruar në banesa. Ndërkaq KOSTT do të kërkojë që këto hapësira prapë të rikthehen në zyre afariste në mënyrë që të ruhet pasuria publike.
Bordi i Drejtorëve ka aprovuar kërkesën për ndërrim të destinimit të lokaleve të KOSTT-it në Kastriot dhe ka urdhëruar që këto hapësira të shndërrohen në zyra afariste.

## 5. Mbledhja e Komisionit të Auditimit nr. 27/12

Me datën 6 Mars 2012 Komisioni i Auditimit ka mbajtur mbledhjen nr. 27/12.
Gjatë mbledhjes Komisioni i Auditimit së pari ka shqyrtuar Raportin vjetor të KOSTT-it për vitin 2011. Menaxhmenti i KOSTT-it ka dhënë shpjegime për disa pika të Raportit të cilat ishin në interesim të anëtarëve të Komisionit të Auditimit. Komisioni ka dhënë disa sugjerime në Raport dhe ka konstatuar se Raporti Vjetor i përmbush standardet dhe praktikat e mira të deritanishme të KOSTT-it, pasi është i përpiluar konform rregullativës ligjore, standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe i përmbush të gjitha kriteret për shqyrtim nga Bordi i Drejtorëve. Komisioni ka sugjeruar që Raporti Vjetor me vërejtjet e Komisionit të shqyrtohen nga Bordi në mbledhjen e ardhshme.

Komisioni i Audtimit në vazhdimësi ka shqyrtuar kërkesën e KOSTT-it për sigurimin e mjeteve buxhetore për furnizimin/blerjen e 2 (dy) Firewalls për projektin e TI për Operim të Tregut. Komisioni ka vlerësuar që kjo kërkesë është e arsyeshme dhe se duhet t'i dërgohet Bordit për shqyrtim dhe aprovim.

## 6. Mbledhja e Rregullt e Bordit nr. 27/12 MË 15 MARS 2012

Bordi në mbledhjen e rregullt të tij me 15 Mars 2012 është informuar me çështjet aktuale për periudhën raportuese nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it.

Bordi është informuar lidhur me aktivitetet për implementimin e Vendimit të Qeverisë për transferin e aseteve 110 kV nga KEK në KOSTT. Bordi ka shprehur kënaqësinë me Vendimin dhe ka shprehur mirënjohje për vendimmarrësit. Poashtu, është cekur se Vendimi është mjaft i favorshëm për KOSTT dhe interesat e konsumatorëve të Kosovës në përgjithësi për finalizimin e aseteve për një afarizëm të suksesshëm të KOSTT.
Bordi u njoftua për nënshkrimin e Marrëveshjes KOSTT-KEK për transferimin e aseteve 400/200/110 kV dhe aprovimin e të njëjtës nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Bazuar në këtë Marrëveshje, BD ka kërkuar nga Menaxhmenti implementimin e Marrëveshjes në bazë të afateve të dhëna dhe përgatitjen er Raportit final për Bordin, pas përfundimit.

Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportin Vjetor të KOSTT-it për vitin 2011 duke vlerësuar se Raporti i përmban të gjitha elementet konform dispozitave ligjore, është gjithëpërfshirës dhe janë paraqitur të gjitha IKP teknike dhe financiare të cilët tregojnë afarizëm pozitiv të KOSTT-it në vitin 2011.

Bordi ka aprovuar kërkesën e KOSTT-it që blerja e 2 (dy) Firewalls për projektin e TI për Operim të Tregut të financohet nga KOSTT-i në vlerë prej 35.000.00 €, për t'i mbuluar të gjitha nevojat e projektit të TI.

Në vazhdimësi Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar Rregulloren për pagesën e shërbimeve komunale për vlerësimin e dëmeve eventuale gjatë ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të Sistemit transmetues (niveli i tensionit 400, 220 dhe 110 kV).

Bordi gjithashtu ka aprovuar kërkesen e KOSTT-it për sigurimin e mjeteve shtesë për rehabilitimin e paisjeve NS Kosova B në vlerë prej 30.000 € në bazë të kërkesës së KOSTT-it.

## 7. Aktivitete të tjera

Drejtorët e Bordit të KOSTT-it në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efiçiencë më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

Bordi i Drejtorëve ka qenë i kyçur në të gjitha aktivitetet e natyrës strategjike të KOSTT-it.

# Lista e shkurtesave

ATR – Autotransformatori

ATC (Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshëm

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

ECLO – ( nga angl. European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

GjQ – Gjykata e Qarkut

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

KA – Konflikt Administrativ

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

LP – Largpërçuesi

NEF (Net Export Flow) – Eksporti i Kosovës

NIF - (Net Import Flow) – Importi neto për nevojat e Kosovës

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managament System)-Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

TP - Tatimi në pronë

ZRrE - Zyra e Rregullatorit të Energjisë